



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 21.06.2019, ora 12.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Diskutimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese

2. Diskutimi dhe miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|-----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Klodiana Veizi | (anëtare zëvendësues) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Enio Haxhimihali, përfaqësues i autorizuar e Avokatit të Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku sipas njoftimit, është e angazhuar në veprimtari të tjera zyrtare të lidhura me problematikat e situatën aktuale.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese

Diskutimi dhe miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit informon se në vijim të diskutimeve, detyrave dhe çështjeve të rëna dakord në mbledhjet e mëparshme, projekti i Metodologjisë është ripunuar duke e sjellë në formatin e duhur sipas standardeve të teknikës legjislative, duke hartuar një pjesë hyrëse shpjeguese të riformuluar tërësisht, si edhe duke reflektuar shtesat dhe ndryshimet e dakordësuara në të tre kategoritë e meritave dhe kriteret e veçanta vlerësuese brenda tyre. Në

mbledhjen e sotme synohet të diskutohen çështjet e mbetura të hapura dhe të përfundohet puna me miratimin e të dyja Metodologjive.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë fillimisht çështjet në pjesën e parë “Meritat Profesionale”, nëngrupin “Historiku arsimor dhe profesional”. Në lidhje me “Historikun arsimor”, ndërmjet varianteve të paraqitur dakordësohen që në vlerësimin e notës mesatare do të konsiderohet ajo e përfundimit të arsimit të lartë juridik. Për kandidatët që janë arsimuar jashtë vendit do të bëhet konvertimi i notës mesatare sipas mënyrave dhe metodave të zbatuara në fushën e arsimit të lartë. Nota mesatare e arritur në shkollën e magjistraturës do të konsiderohet në vlerësimin e rezultateve aty në nëngrupin “Kualifikimet pasuniversitare”, aq më tepër atëherë kur nuk kemi lista të ndara renditjeje në gjyqtarë dhe jogjyqtarë.

Anëtarët e Këshillit kalojnë në diskutimin e nëngrupit “Kualifikimet pasuniversitare të riformuluar sipas diskutimeve në mbledhjet e mëparshme.

Julinda Beqiraj kërkon fjalën dhe parashtron se Këshilli duhet të kujdeset se si do të gjejnë zbatim këto rregulla kur nga akumulimi mund të rezultojnë më shumë se 8 pikë, si p.sh rasti i një magjistrati që është njëkohësisht edhe profesor. Sipas disa informacioneve, në sistemin shqiptar, dikush që ka përfunduar studimet për doktoraturë jashtë Shqipërisë ose në një nga vendet e OECD, automatikisht quhet profesor i asociuar.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë mbi titujt akademikë, gradat shkencore dhe studimet afatgjata dhe vijnë në përfundimin që neni 37 i ligjit për arsimin e lartë i trajton këto raste por nuk i barazon me titullin akademik profesor i asociuar. Vetëm në rastet kur senati i universitetit ka vende bosh, pra nuk e plotëson numrin me profesorë dhe me profesore të asociuar, përfshin në senat edhe anëtarë të cilët kanë marrë grada e tituj në një shtet tjetër europian. Ndërsa mundësia e tejkalimit të 8 pikëve maksimale si rezultat i akumulimit është e shmangur. Edhe në shembullin e dhënë akumulimi sjell 7 pikë dhe pika e fundit mund të caktohet sipas meritës për pjesën tjetër të kriterëve të këtij nëngrupi. Pikët për titujt akademikë dhe gradave shkencore janë fikse, ndërsa ato për specializime dhe studime afatgjata, përfshirë Shkollën e Magjistraturës do të jenë me pikë në minimum dhe maksimum, p.sh, Shkolla e Magjistraturës 3 deri 4 pikë. Në lidhje me komponentin “Trainimet e tjera” konkluduan se aty do të përfshihen vecanërisht trajnime me kohëzgjatje minimale 2 javore, duke pasur parasysh llojin tematikën kohëzgjatjen, llojin e institucionit ku trajnohen, fusha si dhe faktin nëse janë shoqëruar me certifikatë vlerësimi apo jo. Për komponentin e fundit “Njohja e gjuhëve të huaja” pas diskutimeve u konkludua që në maksimum 3 pikë të vlerësohet shkalla e zotërimit të gjuhës së huaj të zgjedhur për verifikim në intervistë sipas metodave të njohura ndërkombëtare të testimit dhe me një pikë shtesë nëse zotëron edhe një

nga 5 gjuhët e tjera me dokument të vlefshëm njohurie. Rast pas rasti Këshilli do të konsiderojë nëse ndonje kandidat mund të përjashtohet nga intervista dhe të fitojë pikët sikurse është shkollimi jashtë vendit.

Anëtarët e Këshillit kalojnë në diskutimin e nëngrupit të kriterëve të vlerësimit “Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional” dhe miratojnë ndryshimin e orientimit të pikëve në maksimum nga 4 në 6 tek indikator Originaliteti dhe/ose impakti, ndërsa nga 6 në 4 tek indikator Aftësia Kërkimore.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe kalojnë kriteret e vlerësimit të nëngrupit “Kualifikimi Shtesë Profesional”.

Anëtarët e Këshillit kalojnë në diskutimin e Pjesës së Dytë “Meritat Morale” dhe në komponentin “Integriteti Etik dhe Moral” riformulojnë titullin dhe përmbajtjen e indikatorit “Detyrimi i ndershmërisë, korrektesës dhe respektit”, ndërsa në komponentin “Reputacioni” shtohet një indikatorë shpjegues lidhur me sjelljet dhe veprimtaritë në jetën e përditshme për realizimin e interesave të ndryshme individuale që nuk perceptohen të pritshme a të përshatshme nga një individ në ushtrimin e një funksioni a detyre profesionale të caktuar apo që mund të ushtrojë detyrën e gjyqtarit kushtetues. Gjithashtu, diskutohet për riformulimin e një tjetër indikator shpjegues të propozuar lidhur me sjellje të lidhura me vjedhje, shkatërrime apo shpërdorime të pronës etj.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet qëndrimin që ky indikator orientues të lidhet me përdorimin e të mirës publike përtej qëllimit, për të cilën i është dhënë në administrim. Flasim për makinë, sende dhe të mira të tjera që është dhënë për funksionin që ka dhe jo për përdorim familjar.

Anëtarët e Këshillit dakordësohen që ky indikator orientues të riformulohet si përdorimi i të mirës publike përtej qëllimit që është dhënë në përdorim ose administrim.

Anëtarët e Këshillit kalojnë sipas riformulimeve të propozuara Pjesën “Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale”.

Anëtarët e Këshillit pasi reflektojnë korrektimet e fundit, e miratojnë me votë unanime përmbajtjen e dokumentit “Metodologjia për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për rënditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”. Përmbajtja e zbardhur me ndryshimet dhe shtesat e dakordësuara të kësaj Metodologjie do të dërgohet më përpara anëtarëve dhe më pas do të bëhet publike.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës për diskutimi dhe miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Rënditjen e Kandidatëve për

Inspektor i Lartë i Drejtësisë., duke pasur parasysh që në shumë elementë përmbajtja është e njëjtë me Metodologjinë për gjyqtarët e Gjykatave Kushtetuese.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), mbi kërkesën e anëtarëve të Këshillit për të dhënë mendime, merr fjalën dhe parashtron se për sa i përket të gjithë metodologjisë, kjo është përqendruar tek vlerësimi për rastin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu është lënë mënjanë vlerësimi dhe tabela ë bërë më herët dhe kemi paraqitur aty disa ndryshime të vogla përsa i përket pikëzimit. P.sh tek trajnimet pasuniversitare, nuk është më 8 pikë, por e kemi bërëderi në 5 pikë. Për sa i përket njohurive të gjuhëve të huaja nga 4 pikë, është reduktuar numri i pikëve deri në 3 pikë. Rekomandohet të mos ndryshojë metodologjia për sa i përket interpretimit të pikëve për njohuritë e gjuhëve të huaja dhe kualifikimeve të ndryshme profesionale.

Lidhur me Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional i kemi qëndruar më pranë gjuhës që përkon me fushën e veprimtarisë të një Inspektori e që ka të bëjë me hetimet dhe këtu gama e fushës së gjuhës së përdorur është më e gjërë sipas rasteve dhe fushës specifike, civile, penale, administrative, e të drejtave të njeriut dhe kështu me rradhë.

Për sa i përket angazhimeve profesionale shtesë, është pak a shumë e njëjta gjë. Është me ato riformulimet që kemi rënë dakord edhe më herët.

Gjithashtu për sa i përket meritave morale edhe këtu është çështje riformulimi që të jetë pranë profilit të inspektorit. Për integritetin moral dhe etik vjen me riformulime dhe kemi shtuar një paragraf. Për sa i përket pjesës të pavarësisë këtu kemi pasur parasysh që pavarësia është e domosdoshme dhe e nevojshme dhe për një gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Por lidhur me profilin e Inspektorit më së shumti shkojmë me perceptimin e një pavarësie të brendshme, sepse Inspektori do të hetojë magjistratë, edhe ai vetë mund të jetë një magjistrat. Kështu që një Inspektor ideal duhet të ketë parimin që të jetë së brendshmi i pavarur. Gjithashtu lidhur me reputacionin është vepruar në të njëjtën mënyrë, është bërë riformulimi dhe i është përshtatur aktit të Inspektorit. Gjithashtu edhe me angazhimet që kanë të bëjnë me shoqërinë civile shkon rasti për riformulim.

Për sa i përket aftësive dhe meritave organizative dhe menaxheriale ka më shumë pikë këtu për Inspektorin dhe jemi përpjekur ta përpunojmë më shumë. Në lidhje me programin dhe vizionin është pak a shumë i njëjtë. Tek aftësitë vendimmarrëse kemi shtuar edhe disa elementë që mund të merren parasysh nga Këshilli në momentin që jepen pikët. Edhe për sa i përket komunikimit dhe aftësive përfaqësuese, ka pasur disa përpunime sepse kemi edhe më shumë pikë.

Megjithatë, si përfundim, ky është një material për tu diskutuar. Ju mbetet juve në dorë për ta pasur parasysh, meqenëse e njihni më mirë situatën, për ta përshtatur të gjithë materialin për figurën e Inspektorit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe kalojnë historikun arsimor, i cili është i njëjtë me atë për Gjykatën Kushtetuese. Lidhur me kualifikimet pasuniversitare pranohen ndryshimet e vlerësimit nga 8 në 5 pikë dhe përgjithësisht përgjysmohen pikët për titujt akademikë, gradat shkencore, studimet afatgjata etj. krahasuar me vlerësimin për gjyqtarët kushtetues. Për nivelin e njohurive të gjuhës së huaj vlerësimi maksimal të jetë 3 pikë. Kalohet pa ndryshime kriteri i vlerësimit Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional, ndërsa tek Kualifikimi Shtesë Profesional dakodësohet e kaluar me ndryshimet përkatëse të lidhura me natyrën dhe figurën profesionale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në pjesën Merita Morale numri maksimal i pikëve të jetë 25, ndërkohë pranohet propozimi që për vlerësimin e integritetit moral dhe etik dhe të reputacionit, krahas parimeve të tjera etike e morale për gjyqtarët, të mbahen parasysh edhe standardet mbi integritetin dhe efikasitetin e inspektorëve në SHBA. Në grupkriteret e vlerësimit “integriteti etik dhe moral”, indikatorit shpjegues “Pavarësia” kalohet me disa ndryshime duke u fokusuar edhe më shumë tek cilësitë për të qëndruar korporativizmit, pandikueshmërisë në detyrë në raportet me magistratët etj. duke ndryshuar edhe titullimin në “Pandikueshmëria në ushtrimin e detyrës”.

Në pjesën “Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale” për të gjitha kriteret e vlerësimit bazuar në vendimin normativ nr.5/2019 dhe Shtojcën nr. 2 të tij janë përcaktuar më shumë pikë dhe në përmbajtjen e orientimeve për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për secilën prej tyre pas diskutimeve konkludohet të përfshihen sipas propozimit të projektit më shumë elementë konkretë e të hollësishëm të lidhura me natyrën dhe kompetencat që duhet të ushtrojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe lidhur me kriterin vlerësues Aftësitë Vendimmarrëse sugjeron që kur flasim për mirëorganizimin e strukture, kjo ka të bëjë edhe me përdorimin efikas të burimeve njerëzore në dispozicion, në veprimtaritë që ka kryer dhe jo thjesht për ato që duhet të bëjë në të ardhmen sepse ato i ka të përcaktuara në ligj. Mund të mbahet parasysh edhe se ka institucione që kanë qenë të pambështetura politikisht dhe nuk kanë funksionuar dot, jo për shkak se nuk dinin por për shkak se nuk mundën. Në atë periudhë i ke aq të sulmuar dhe mund të jetë krijuar imazhi që nuk ka ditur të administronte 18 apo 20 veta. Prandaj gjithmonë e kam thënë që intervista me kandidatët do të shtrihet edhe në këtë drejtim. Ka një jetëshkrim të kandidatit për tu vlerësuar por janë edhe pyetjet e Këshillit që janë të hapura për këtë qëllim.

Anëtarët e Këshillit e kalojnë me shtesat dhe ndryshimet e propozuara dhe ato të dakordësuara edhe Pjesën “Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale”.

Anëtarët e Këshillit me shtesat dhe ndryshimet e dakordësuara, e miratojnë me votë unanime përmbajtjen e dokumentit “Metodologjia për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për rënditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”. Përmbajtja e zbardhur me ndryshimet dhe shtesat e dakordësuara të kësaj Metodologjie do ti dërgohet më parë anëtarëve dhe më pas do të bëhet publike.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon anëtarët se ka ardhur thuajse të gjitha informacionet dhe dokumentacioni i kërkuar për kandidatët në të gjitha vendet vakante. Për një apo dy kandidatë jemi në pritje të përgjigjes nga DSIK që edhe ato duhet të vijnë. Praktikisht javës tjetër edhe relatorët duhet të vinë këtu sepse duhet të përgatisim vendimmarrjen. Këshilltarët ndërkohë projektvendimet i kanë mbushur me të gjithë elementet dhe kanë ngelur vetem momenti final i vlerësimit nga ne për lejim. ndalim kandidimin. Kemi 11 raporte jo pozitive nga ILDKP dhe 6 pozitive. Deri tani për integritetin e kandidatëve nga DSIK i kemi të gjitha pozitive, presim edhe të fundit që do të vijë dhe ka kaluar kohë. Duhet të mblidhemi të organizohemi që në fund të javës të marrim vendimet jo vetëm për këta 17 kandidatë, por edhe për disa të tjerë që sigurisht koha dhe rezultati varen nga organet e vettingut. Pra janë gjithsej 23 vendime për lejim ose ndalim kandidimi. Duhet të organizohemi për javën tjetër. Po kështu sapo më informojnë se të hënën do të vijnë certifikatat e sigurisë dhe ndoshta edhe informacioni për kandidaten që kanë ngelur.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve, duke njoftuar se në mbledhja e ardhshme parashikohet të jetë të premtën tjetër dhe orari i saj do të njoftohet në varësi njoftimit për kohëzgjatjen e raportit të KED përpara Komisionit të Monitorimit të Kuvendit, deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 14.05

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Redjona MYRTJA

Dorina DULAJ

KRYETARI

Ardian DVORANI

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.